REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA POGRADEC**
**KËSHILLI**

Nr.3807/Prot. (1)

Pogradec, më 22.08.2022

**VENDIM**

**NR. 81, DATË 19.08.2022**

**MIRATIMI I PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS 19.08.2022 TË KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC**

Këshilli I Bashkisë Pogradec në mbledhjen e tij të datës së sotme,pasi lexoi proces-verbalin e zbardhur nga Sekretarja e Këshillit të mbledhjes së datës 19.08.2022, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, pika 8 dhe neni 54, gërma k si dhe neni 92 e Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec miratuar me VKB nr 40, datë 05.03.2020.

**KËSHILLI I BASHKIAK**

**VENDOSI:**

1. Të miratojë proces verbalin e mbledhjes të Këshillit të Bashkisë Pogradec , të datës 19.08.2022 bashkangjitur.
2. Kopja e proces verbalit të miratuar administrohet nga Sekretarja e Këshillit sipas procedurave ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I KËSHILLIT**

**Sotiraq MANGËRI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

**Mbledhje e Këshillit Bashkiak**

Pogradec më ___.___. 2022

ORA : ___:___

JANË PREZENT 17 KËSHILLTARË

PROTOKOLLI I MBLEDHJSES SË KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC DATE 19.07.2022 ME KËTË REND DITE.

RENDI I DITËS

pika 4, me këtë rend dite :

1. **Projekt – vendim:** Miratimi i Rendit të ditës së Mbledhjes, sipas nenit 53, pika 5, ligji 139/2015.
2. **Projekt – vendim:** Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së datës 22.06.2022 të Këshillit Bashkiak Pogradec
3. **Projekt – vendim:** Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, për muajin Qershor 2022
4. **Projekt – vendim:** Miratimin e Planit të masave për të dalë nga gjëndja e vështirësive financiare.
5. **Projekt – vendim:** Miratimin e Tavaneve përfundimtare buxhetore për Programin Buxhetor afatmesëm 2023-2025 të Bashkisë Pogradec.
6. **Projekt – vendim:** Për miratimin e shtojcës së planit të mbrojtjes sociale të bashkisë Pogradec me qëllim përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar.
7. **Projekt – vendim:** "Detajimin dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile"
8. **Projekt – vendim:** "Për miratimin e kërkesës familjes së z.Përparim Kasmollari që do të vazhdojë procedurën e privatizimit të banesës shtetërore që ka mbetur pa privatizuar.
9. **Projekt – vendim:** Rimiratimin e kërkesës së znj.Ekleva Jugu ai fituese e programit të subvenconimit të interesave të kredisë sipas VKM nr.301, datë 15.04.2020.
10. **Projekt – vendim:** Rimiratimin e kërkesës së z.Klajdi Pillati si fitues I programit të subvencionimit të interesave të kredisë sipas VKM nr.301, datë 15.04.2020.
11. **Projekt – vendim:** Rimiratimin e kërkesës së z.Altin Marko si fitues I programit të subvencionimit të interesave të kredisë sipas VKM nr.301 datë 15.04.2020.
12. **Projekt – vendim:** "Rimiratimin e kërkesës së z.Dorjan Pllaha si fitues I programit të subvencionimit të interesave të kredisë sipas VKM nr.301, datë 15.04.2020.
13. **Projekt – vendim:** Për dhënien e ndihmës financiare z.Nertil Xhafer, ppër dëmet e shkaktuar nga rënia e zjarrit në banesë.
14. **Projekt – vendim:** Per dhenien e ndihmes financiare z.Firdes Balliu, për dëmet e shkaktuara nga përmbytja në banesë.
15. **Projekt – vendim:** Për dhenien e ndihmes financiare z.Antonio Gjona, për dëmet e shkaktuara nga era e fortë.
16. **Projekt – vendim:** Marrje ambjenti dhe objekti me qera , për të shërbyer si kopshte.

17. **Projekt – vendim:** Për paraqitjen për miratim të marrëveshjes për krijimin e shoqërisë rajonale Ujësjellës Kanalizime Pogradec Sh.a
18. **Ankese:** Qytetarja D.M ankohet ne lidhje me sheshin perball pallatit te saj i cili është zënë nga një qytetar tjeter dhe ushtron një aktivitet qe shkakton ndotje dhe zhurma.

**Propozime dhe diskutime**

Znj. M. Kamolli

Përshëndetje të gjithve,
Fillojmë mbledhjen e Këshillit Bashkiak, date 19.07.2022. Janë prezent 17 Këshilltarë.
Jemi njohur me materialet e rendit të ditës të mbledhjes dt. 19.07.2022, por kemi edhe një projekt-vendim shtesë "Për kthimin e kopshtit "Tomka Lasko" në kopësht me ushqim"
Ftoj këshilltarët të hedhim në votim rendin e ditës në mbledhjes dt. 19.07.2022, duke përfshirë edhe projekt-vendimin shtesë.

HIDHET NE VOTIM RENDI I DITES::

PRO 17

KUNDËR 0

ABSTENIM 0

**Miratohet** Po Jo

Miratohet rendi i ditës, duke përfshirë edhe projekt-vendimin shtesë, me 17 vota pro.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA POGRADEC

**Mbledhje e Këshillit Bashkiak**

Pogradec më ___.___. 2022

**1.Pika nr ___** : " Miratimi i Rendit të ditës së Mbledhjes, sipas nenit 53, pika 5, ligji 139/2015".

Diskutime

M. Kamolli

Vazhdojmë me pikën nr. 1, të rendit të ditës.
Ftoj këshilltarët të hedhim në votim pikën nr. 1 "Miratimi i rendit të ditës së Mbledhjes, sipas nenit 53, pika 5, ligji 139/2015"

## U votua

Pro 17

Kundër 0

Abstenim 0

**Miratohet** Po Jo

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA POGRADEC

Miratohet pika nr. 1 e rendit të ditës
vota pro.

**Mbledhje e Këshillit Bashkiak** Pogradec më ___.___. 2022

**2. Pika nr ___** : " Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së datës 22.06.2022 të Këshillit Bashkiak Pogradec".

Diskutime

M. Kamdli :

Pika nr. 2 e rendit të ditës është " Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes datë 22.06.2022 të Këshillit Bashkiak Pogradec". Edhe ky është një projekt-vendim rutinë, ndaj ftoj këshilltarët të hedhin në votim pikën nr. 2 të rendit të ditës.

**U votua**

**Pro** 17

**Kundër** 0

**Abstenim** 0

Miratohet pika nr. 2 e rendit të ditës me 17 vota pro.

Miratohet Po Jo

**Mbledhje e Këshillit Bashkiak**

Pogradec më ___.___. 2022

**3.Pika nr ___** : "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, për muajin Qershor 2022

Diskutime

Znj. M. Kamolli

Pika në vazhdim është "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, për muajin Qershor 2022."
Ftojmë drejtoreshën e ndihmës ekonomike,

Znj. Ivana

Nga dokumentacioni i paraqitur, si dhe nga verifikimet e kryera nga administratorët e njësive përkatëse, konkludojmë dhe propozojmë:
Të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi 6% i fondit të kushtëzuar të ndihmës ekonomike për muajin Qershor 2022, 169 familje, me fond 591174 lekë.

Z. C. Hoxhilllari:

Ky është një projekt – vendim rutinë.

Znj. M. Kamolli

Ftoj këshilltarët të hedhim në votim pikën nr. 3 të rendit të ditës.

**U votua**

**Pro** 17

**Kundër** 0

**Abstenim** 0

**Miratohet Po Jo**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA POGRADEC

**Mbledhje e Këshillit Bashkiak** Pogradec më ___.___. 2022

**4.Pika nr ___** : "Miratimin e Planit të masave për të dalë nga gjëndja e vështirësive financiare".

Diskutime

Znj. M. Kamalli: Në vazhdim është është projekt-vendimi për "Miratimin e Planit të masave për të dalë nga gjëndja e vështirë financiare."
Ftojmë drejtoreshën e financës
I. Karapanço: Duke studiuar gjendjen e vështirë në të cilët ndodhemi, duhet që të kryejmë disa procedura për të dalë nga kjo gjendje.
Plani është llogaritur për 6 muajt në vazhdim, por duke parë ecurinë e mbledhjes së të ardhurave dhe mbledhjes së borxhit, do të mundohemi për një masë të tillë të shlyejmë detyrimet e prapambetura.
Kërkojmë ~~miratimin~~ mirekuptimin tuaj në miratimin e këtij Plani masash.
S. Hoxhillari: Ky plan masash është përpunuar tek detyrimet e prapambetura.
E vetmja mënyrë për të dalë nga kriza, është shlyerja e detyrimeve të prapambetura.
F. Force: Pse borxhi nuk është likuiduar.
I. Karapanço: Kjo ndodh për shkak të vendimeve gjyqësore për shkak të largimeve nga puna nga 2015 e në vazhdim.
M. Kamalli: Ftoj këshilltarët të hedhin në votim pikën nr. 4. të rendit të ditës.

**U votua** Largohet A. Loska

**Pro** 16

**Kundër** 0

**Abstenim** 0

**Miratohet** (Po) Jo

Miratohet pika nr. 4. e rendit të ditës me 16 vota pro.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POGRADEC

**Mbledhje e Këshillit Bashkiak** Pogradec më ___.___. 2022

**5.Pika nr :** "Miratimin e Tavaneve përfundimtare buxhetore për Programin Buxhetor afatmesëm 2023-2025 të Bashkisë Pogradec".

Diskutime

M. Kamolli . Pika nr. 5. është për "Miratimin e Tavaneve përfundimtare buxhetore për Programin Buxhetor afatmesëm 2023-2025 të Bashkisë Pogradec".
J. Karapanço: Këto janë shtojcat që dërgon Ministria e Financave. Tavanet Buxhetore përfundimtore, duhen me vendim Këshilli.
M. Kamolli: Ka dikush ndonjë pyetje? Atëherë ftoj këshilltarët të kalojmë në votim pikën nr. 5. të rendit të ditës.

## U votua

**Pro** 16

**Kundër** 0

**Abstenim** 0

**Miratohet** Po Jo

Miratohet pika nr. 5. e rendit të ditës me 16 vota pro.

**Mbledhje e Këshillit Bashkiak** Pogradec më ___.___. 2022

**6 Pika nr ___** : "Për miratimin e shtojcës së planit të mbrojtjes sociale të bashkisë Pogradec me qëllim përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar".

Diskutime

M. Kamolli. Vazhdojmë me pikën nr. 6 të rendit të ditës. Ftojmë drejtoreshën e shërbimeve sociale.
J. Capallari:
Bëhet fjalë për një shtojcë në planin e mbrojtjes sociale të Bashkisë Pogradec, me qëllim përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar.
Është një projekt i financuar nga UNDP-ja.
Ky plan është me shumë ~~[illegible]~~ për personat me aftësi të kufizuar.
Sh. Blakëri: Mafarealli ishte po të merr. Vetëm shpresoj për të vihet në zbatim. Duhet shumë punë dhe buxhet.
Unë do të jepja një sugjerim. Të vendoset një autobus për 20 njëshit familje për këto familje me të marrë në shtëpi, për këto të marrin si duhet shërbimin.
J. Capallari: Bashkia është pjesë e projektit.

M. Kamolli: Ftoj këshilltarët të kalojmë në votim pikën nr. 6 të rendit të ditës.

**U votua**

**Pro** 16

**Kundër** 0

**Abstenim** 0

**Miratohet** (Po) Jo

Miratohet pika nr. 6 e rendit të ditës me 16 vota pro.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POGRADEC

**Mbledhje e Këshillit Bashkiak** Pogradec më ___.___. 2022

**7.Pika nr ___ :** "Detajimin dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile".

Diskutime

M. Kamolli: Projekt-vendimi nr. 7, është për "Detajimin dhe përdorimin e fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile".

J. Kamponca:

Projekt-vendimi që po paraqitim përpara jush për miratim ka të bëjë me shpërndarjen e fondeve për emergjencat civile. Në bazë të VKM 414 dt. 08.07.2021, kemi bërë shpërndarjen e fondeve duke respektuar kriterin e VKM. Duke u bazuar tek nevojat e Bashkisë dhe Drejtorisë së Emergjencave kemi zërat e mëposhtëm, të cilat i kemi për miratim.

M. Kamolli: Ftoj këshilltarët të hedhin në votim pikën nr. 7.

## U votua

**Pro** 16

**Kundër** 0

**Abstenim** 0

**Miratohet** Po Jo

Miratohet pika nr. 7. e rendit të ditës me 16 vota pro.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POGRADEC

**Mbledhje e Këshillit Bashkiak** Pogradec më ___.___. 2022

**8. Pika nr ___** : "Për miratimin e kërkesës familjes së z.Përparim Kasmollari që do të vazhdojë procedurën e privatizimit të banesës shtetërore që ka mbetur pa privatizuar".

Diskutime

M. Kamolli: Projekt - vendimi i radhës është për z. Përparim Kasmollari: që do të vazhdojë procedurën e privatizimit të banesës shtetërore që ka mbetur e paprivatizuar.

K. Lickollari:
Është një kërkesë për privatizim të një apartamenti 1+1, në qytetin Pogradec. Dokumentacioni është në rregull, për të vazhduar procedurat për privatizim të banesës pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Pogradec.

Q. Këshilltari: Raste të tilla, kemi pasur edhe më parë, dhe ne ja kemi dhënë aprovimin tonë ndaj mendoj ti miratojmë.

M. Kamolli: Unë shikoj që për rastet e tjera të merret një vërtetim nga Enti i banesave.

Ftoj këshilltarët të kalim në votim pikën nr. 8 të rendit të ditës.

## U votua

Pro 14

Kundër 0

Abstenim 2

**Miratohet** (Po) Jo

Miratohet pika nr. 14 e rendit të ditës me 24 vota pro.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA POGRADEC

**Mbledhje e Këshillit Bashkiak** Pogradec më ___.___. 2022

**9. Pika nr ___ : ":** Rimiratimin e kërkesës së znj.Ekleva Jugu ai fituese e programit të subvencionimit të interesave të kredisë sipas VKM nr.301, datë 15.04.2020".

Diskutime

M. Kamolli: Projekt-vendimi në vazhdim është një rimiratim i kërkesës së znj. E. Jugu si fituese e programit të subvencionimit të interesave të kredisë sipas VKM. nr. 301 datë 15.04.2020.

K. Lickollari:
Bëhet fjalë për një zonjë e cila ka qenë përfituese e programit të kredisë së butë, por për arsye personale ajo nuk e ka vazhduar procedurën e marrjes në bankë.

C. Kashillari:
Rasti i zonjës E. Jugu nuk është i vetmi dhe ne i kemi kaluar, ndaj të votojmë.

M. Kamolli:

Ftoj këshilltarët të hedhin në votim pikën nr. 9 të rendit të ditës.

## U votua

**Pro** 16

**Kundër** 0

**Abstenim** 0

**Miratohet** (Po) Jo

Miratohet pika nr. 9 e rendit të ditës me
vote pro.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POGRADEC

**Mbledhje e Këshillit Bashkiak** Pogradec më ___.___. 2022

**10. Pika nr ___ :** "Rimiratimin e kërkesës së z.Klajdi Pillati si fitues I programit të subvencionimit të interesave të kredisë sipas VKM nr.301, datë 15.04.2020".

Diskutime

M. Kamolli ;

Edhe ky projekt-vendim eshte i njejti rast si me ate te meparshim, ndaj ftoj keshilltaret te hedhim ne votim.

**U votua**

**Pro** 16

**Kundër** 0

**Abstenim** 0

**Miratohet** Po Jo

Miratohet pika 10, e rendit te dites me [illegible] vota pro.

REPUBLIKA E SHQIPERISE BASHKIA POGRADEC

**Mbledhje e Këshillit Bashkiak**

Pogradec më ___.___. 2022

**11. Pika nr ___** "Rimiratimin e kërkesës së z.Altin Marko si fitues I programit të subvencionimit të interesave të kredisë sipas VKM nr.301 datë 15.04.2020".

Diskutime

M.Kamolli: ; edhe pika 11. është i njejti rast ndaj të hedhim në votim mendoj.

**U votua**

**Pro** 16

**Kundër** 0

**Abstenim** 0

**Miratohet** Po Jo

Miratohet pika nr. 11, e rendit të ditës me 16 vota pro.

**Mbledhje e Këshillit Bashkiak**

Pogradec më ___.___. 2022

**12. Pika nr** ___ "Rimiratimin e kërkesës së z.Dorjan Pllaha si fitues I programit të subvencionimit të interesave të kredisë sipas VKM nr.301, datë 15.04.2020".

Diskutime

M. Kamolli:

Projekt - vendimi i rradhës është "Rimiratimi i kërkesës së z. Dorjan Pllaha si fitues i programit të subvencionimit të interesave të kredisë sipas VKM nr. 301, datë 15.04.2020".

Ftoj këshilltarët të kalojmë në votim pikën nr. 12 të rendit të ditës.

**U votua**

**Pro** 16

**Kundër** 0

**Abstenim** 0

**Miratohet** (Po) **Jo**

Miratohet pika nr. 12 e rendit të ditës, me 16 vota pro.

BASHKIA POGRADEC - REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Mbledhje e Këshillit Bashkiak** Pogradec më ___.___. 2022

**13. Pika nr ___ Projekt- Vendim :** "Për dhënien e ndihmës financiare z.Nertil Xhafer, ppër dëmet e shkaktuar nga rënia e zjarrit në banesë".

Diskutime

M. Kamolli :

Projekt – vendimi nr. 13 është "Për dhënien e ndihmës financiare z. Nertil Xhafer, për dëmet e shkaktuar nga rënia e zjarrit në banesë".

R. Ymeraj :

Bëhet fjalë për z. Nertil Xhafer, në fshatin Hudenisht. Familja e tij ka pësuar dëme për shkak të rënies së zjarrit në banesë.

M. Kamolli :

Ftoj këshilltarët të hedhin në votim pikën nr. 13

**U votua**

**Pro** 16

**Kundër** 0

**Abstenim** 0

**Miratohet** **Po** **JO**

Miratohet pika nr. 13 e rendit të ditës me 16 vota pro.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA POGRADEC

**Mbledhje e Këshillit Bashkiak** Pogradec më ___.___. 2022

**14. Projekt-Vendim Shtese**: "Per dhenien e ndihmes financiare z.Firdes Balliu, për dëmet e shkaktuara nga përmbytja në banesë".

M. Kamolli: Projekt-vendimi i radhës është "Për dhënien e ndihmës financiare z. Firdes Balliu, për dëmet e shkaktuara nga përmbytja në banesë".

R. Ymeraj:

Z. Firdes Balliu, nga fshati Stabinjot, i banesa e tij ka pësuar dëme për shkak të përmbytjes nga shiu.

Dëmi i shkaktuar në banesë nga ana ndërtimore, nga përmbytja (mëgjol në banesë) është në shumën 138.500 lekë.

M. Kamolli:

Atëherë të gjithë këshilltarët të hedhim në votim projekt-vendimin nr. 14, të rendit të ditës

## U votua

**Pro** 16

**Kundër** 0

**Abstenim** 0

**Miratohet** Po JO

Miratohet pika nr. 14 e rendit të ditës me 16 vota pro.

**Mbledhje e Këshillit Bashkiak** Pogradec më ___.___. 2022

**15. Kërkesë :** "Për dhenien e ndihmes financiare z.Antonio Gjona, për dëmet e shkaktuara nga era e forte".

Diskutime

M. Kamolli:

Projekt-vendimi i radhës është "Për dhënien e ndihmës financiare të z. Anton Gjona, për dëmet e shkaktuara nga era e fortë".
Flej z. Roland Ymeraj.

R. Ymeraj:

Z. Anton Gjona është banues i fshatit Lakteshi, Mokër e Poshtme.
Banesa e tij ka [illegible] pësuar dëmtime nga ana ndërtimore, për shkak të erës së fortë.
Vlera e shlyerjes së dëmit prej 50% është 35400 lekë.

M. Kamolli: Atëherë ftoj këshilltarët të kalojnë në votim pikën nr. 15 të rendit të ditës.

**U votua**

**Pro** 16

**Kundër** 0

**Abstenim** 0

**Miratohet** (Po) JO

Miratohet pika nr. 15. e rendit të ditës me 16 vota pro.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POGRADEC

**Mbledhje e Këshillit Bashkiak** Pogradec më ____.____. 2022

16. **Projekt – vendim:** Marrje ambjenti dhe objekti me qera , për të shërbyer si kopshte

Diskutime

M. Kamolli:

Ky projekt-vendim është për marrje ambjenti dhe objekti me qera, për të shërbyer si kopësht.
Pungjegjësja e arsimit do të na sqarojë.

M. Shkulleku:

Bëhet fjalë për disa ambjente të marra me qera, për t'u përdorur si kopësht.
Në fshatin Selca e Poshtme, në Njësinë Administrative Proptisht.
Në fshatin Çelivar në Njësinë Administrative Trebinjë.
Në fshatin Bërzeshtë, në Njësinë Administrative Velçan.
Në fshatin Stropckë, në Njësinë Administrative Udenisht.
Në fshatin Mëhovec, në Njësinë Administrative Çërravë,
dhe në fshatin Peqonisht, në Njësinë Administrative Udenisht. Do donim mirëkuptimin tuaj, për miratimin e këtij projekt-vendimi.

M. Kamolli:
Të nderuar këshilltarë, të kalojmë në votim pikën nr. 16 të rendit të ditës.

## U votua

**Pro** 16

**Kundër** 0

**Abstenim** 0

**Miratohet** Po JO

Miratohet pika nr 16 e rendit të ditës me 16 vota pro.

18. M. Kamolli, Vazhdojmë me projekt-vendimin shtesë
" Për kthimin e Kopshtit "Tomka Laska" me ushqim.".
Kemi drejtoreshën e kopshtit.

S. Allka -> Përshëndetje të gjithëve.
Ne si staf, po e sjellim këtë projekt-vendim, si pasojë e kërkesave të shumta që kanë prindërit, të cilët duan që ky kopësht të jetë me drekë (ushqim).
Këtu kam edhe prindër të cilët mund të na flasin për këtë kërkesë.

M. Kamolli,
Në projekt-vendim nuk ka një ~~[illegible]~~ preventiv i cili të shpjegojë në mënyrë të hollësishme shpenzimet që do të jenë të nevojshme.
Do këtë shtim stafi besoj.
S. Allka: Në punonjëse ndihmëse jo.
M. Kamolli -> Do të këtë në guzhinë, në pastrim besoj.
E. Hexhillari -> Kosto do këtë besoja, por nëse jemi në shërbim të komunitetit, kjo justifikohet besoj.
M. Kamolli; Atëherë ftoj këshilltarët të hedhim në votim projekt-vendimin nr. 18.
Pro 15
Abst. 1 R. Gaiser.
Miratohet projekt-vendimi shtesë, me 15 vota pro.

**18. Ankese:** Qytetarja D.M ankohet ne lidhje me sheshin perball pallatit te saj i cili është zënë nga një qytetar tjeter dhe ushtron një aktivitet qe shkakton ndotje dhe zhurma.

M. Kamolli: Donika Mukollari ankohet ne lidhje me sheshin perballe pallatit te saj, i cili eshte zene nga nje qytetare tjeter dhe ushtron nje aktivitet qe shkakton ndotje dhe zhurme.

D. Mukollari: Eshte nje ankese te cilen e kam bere prej vitesh, por nuk me kane dhene asnje zgjidhje.

Ne dore kam te gjitha dokumentet, kerkesat, vendime gjykate.

Ju lutemi na e zgjidhni hallin qe kemi sepse kjo nuk eshte vetem per ne, por edhe per qytetin.

M. Kamolli, kerkesen do tja delegojme Policise Bashkiake.

Mbledhjen e deklaroj te mbyllur.

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA POGRADEC